



REPUBLIKA E SHQIPERISË



MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË



MINISTRIA E FINANCËVE DHE
EKONOMISË

NJOFTIMI I PROCEDURES KONKURRUESE TË PËRZGJEDHJES SË PJESËMARRËSVE NË KAPITALIN E OPERATORIT TË TREGUT

1. Emri dhe adresa e Komisionit te Posaçem

Emri Komisioni i Posaçem
Adresa Ministria e Infrastrukturae dhe Energjise, Rr. "Abdi Toptani", Nr.1,
Tirane, Shqiperi
Tel/Fax +355 4 2222245
Faqja e Internetit www.infrastruktura.gov.al
Personi i kontaktit: Kledia Ngjela - Kledia.Ngjela@infrastruktura.gov.al

2. **Përshkrim i shkurtër i Objektivit te Procedures se Perzgjedhjes:** Në mbështetje të nenit 57, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" (të ndryshuar), VKM Nr. 322, datë 15.05.2019 dhe VKM Nr. 609, datë 11.09.2019, është vendosur krijimi i Operatorit të Tregut (Bursa Shqiptare e Energjisë), si struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar nëpërmjet platformës së tregut, i cili do të operojë në fushën e shkëmbimit të energjisë elektrike në Shqipëri, në formën e një shoqërie aksionare, të ndarë financiarisht dhe ligjërisht nga "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a..

Përzgjedhja e personave të tjerë juridikë që do të bëhen pjesë në strukturën e pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut (përveç "Operatorit të Sistemit të Transmetimit" sh.a. – OST sh.a.) do të kryhet përmes procedurës konkurruese përzgjedhëse, nga Komisioni i Posaçem i ngritur nga Ministri i MIE dhe Ministri i MFE.

Kapitali fillestar i shoqërisë do të jetë 250.000.000,00 (dyqind e pesëdhjetë milion) leke dhe është i ndarë 250.000,00 (dyqind e pesëdhjetë mijë) aksione me vlerë nominale 1.000,00 (një mijë) leke secili. Çdo aksion ka vlerë të barabartë.

Numri i aksioneve në dispozicion të subjekteve që mund të jenë pjesë e strukturës së pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut, do të jetë:

- a) Operatorë të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike - TSO (perjashtuar OST sh.a.) – **51.250,00** (pesëdhjetë e njëmijë e dyqind e pesëdhjetë) aksione (ekuivalent me **20,5 %** të kapitalit aksionar)
- b) Operatorë me Eksperiencë Ndërkombëtare - OEN – **61.250,00** (gjashtëdhjetë e njëmijë e dyqind e pesëdhjetë) aksione (ekuivalent me **24,5 %** të kapitalit aksionar);
- c) Pjesëmarrës në Tregun e Energjisë Elektrike - PTE – **25.000,00** (njëzet e pesë mijë) aksione (ekuivalent me **10 %** të kapitalit aksionar);
- d) Institucione Financiare Ndërkombëtare - IFN-të – **25.000,00** (njëzet e pesë mijë) aksione (ekuivalent me **10 %** të kapitalit aksionar).

Secili pjesëmarrës duhet të paraqesë vetëm një propozim vetëm për një kategori të sipërpërmendur.

Numri i aksioneve të rezervuar për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. – OST sh.a. do të jetë 87.500,00 (tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) ekuivalenti me 35% e kapitalit të shoqërisë së Operatorit të Tregut. Në varësi të zhvillimit të procedurës konkurruese të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e Operatorit të Tregut, kjo përqindje do të rritet në përputhje me parashikimet e këtyre Dokumentave të Procedurës Konkurruese për Përzgjedhjen dhe VKM Nr. 609, datë 11.09.2019.

3. Afati kohor për **dorëzimin e propozimeve** nga subjektet e interesuar për të marrë pjesë në procedurë: Data **27/04/2020**, për secilin pjesëmarrës sipas kategorive ku marrin pjesë, orari do të jetë si më poshtë vijon:

Institucione Financiare Ndërkombëtare - IFN-të	ora 12:00
Operatorë me Eksperiencë Ndërkombëtare - OEN	ora 12:30
Operatorë të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike - TSO	ora 13:00
Pjesëmarrës në Tregun e Energjisë Elektrike - PTE	ora 13:30

4. Afati kohor për **hapjen e propozimeve** nga subjektet e interesuar për të marrë pjesë në procedurë: Data **27/04/2020**, për secilin pjesëmarrës sipas kategorive ku marrin pjesë, orari do të jetë si më poshtë vijon:

Institucione Financiare Ndërkombëtare - IFN-të	ora 12:00
Operatorë me Eksperiencë Ndërkombëtare - OEN	ora 12:30
Operatorë të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike - TSO	ora 13:00
Pjesëmarrës në Tregun e Energjisë Elektrike - PTE	ora 13:30

5. **Pagesa e tarifës së pjesëmarrjes në procedurën konkurruese:** Pjesëmarrësit në procedurë, që dëshirojnë të marrin pjesë në Procedurën Konkurruese Perzgjedhese duhet të paguajnë paraprakisht një tarifë pjesëmarrje (“Tarifa e Pjesëmarrjes”), si dhe do të sigurojnë për Komisionin e Posacem një person kontakti (“Kontakti i Pjesëmarrësve ne procedure”) dhe adresën elektronike të e-mailit të Kontaktit të Pjesëmarrësve ne procedurë, adresë e cila do të përdoret nga Komisioni i Posacem në të gjitha dhe çdo korrespondencë me Pjesëmarrësin në procedurë dhe njoftimet përkatëse, për periudhën deri në momentin e dorëzimit të propozimit. Pjesëmarrësve në procedurë, do t’u kërkohet të provojnë pagesën e Tarifës së Pjesëmarrjes në Procedurën Konkurruese Perzgjedhese, duke përcaktuar emrin e Pjesëmarrësve në procedurë në emër të së cilit paguhet kjo tarifë. Kjo Tarifë e Pjesëmarrjes nuk rimbursohet për asnjë arsye. Nëse personi/subjekti i interesuar vepron si përfaqësues i autorizuar i një shoqërie, ata duhet të paraqesin autorizimin me shkrim të përfaqësimit të shoqërisë.

Komisioni i Posacem ju vë në dispozicion subjekteve që kanë paguar tarifën e pjesëmarrjes, një kopje të Dokumenteve të procesit konkurrues në gjuhën shqipe ose angleze, sipas kërkesës me shkrim së tyre. Tarifa e pjesëmarrjes në procesin konkurrues është 1 000 Euro (njemije euro). Pagesa do të bëhet në llogarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, me të dhënat si më poshtë:

Emri i Institucionit Përfitues:	Operatorit të Sistemit të Transmetimit
Emertimi i Llogarise:	IBAN: AL63212110160000000000142152
Banka:	Credins Bank
SWIFT:	CDISALTR

Blerje dokumentash per procedurën: Perzgjedhja e persona të tjerë juridikë që do të bëhen pjesë në strukturën e pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut, sipas strukturese aksionareve të përcaktuara në VKM Nr. 322, datë 15.5.2019 “Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të operatorit të

tregut” dhe VKM Nr. 609, datë 11.9.2019 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e operatorit të tregut”.

Me përshkrimin:

Pagesë e Tarifës për Pjesëmarrjen në procedurën konkurruese për përzgjedhjen e persona të tjerë juridikë që do të bëhen pjesë në strukturën e pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut

Tarifa e pjesëmarrjes në procesin konkurrues është e pakthyeshme.

Vetëm pjesëmarrësit që kanë paguar Tarifën e Pjesëmarrjes, do kenë të drejtë të marrin kopje të Dokumentave të Procedurës Konkurruese Përzgjedhese dhe do të kenë të drejtë të marrin pjesë në Procedurë.

6. Dokumentet e procesit konkurrues mund të tërhiqen nga subjektet e sipërcituara duke filluar nga data 03.03.2020, çdo ditë të javës, me përjashtim të ditës së shtunë dhe të dielë, nga ora 9:00 deri në orën 14:00 në Zyres së Protokollit në seline e Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST shp në adresën: Autostrada Tirane –Durrës, km 9, Yrshek –Kashar, Tiranë, Shqipëri.